



## CONSORZIO DI BACINO BASSO NOVARESE MANUAL I SHKURTËR PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR

Në Komunën tuaj është i pranishëm një sistem grumbullimi derë më derë për llojet kryesore të plehrave.



**PJESË ORGANIKE** (mbeturina nga kuzhina, teprica nga ushqime të përgatitura ose jo, materiale dhe prodhime të biodegradueshme, kartpeceta, kuti çaji, mbetjet e kafesë, lëvozhgat e vezëve): tërhiqen dy herë në javë; duhet të përdoren qese të biodegradueshme, të cilat jepen nga Komuna si dhe kontejnër përkatës të brendshëm e të jashtëm.



**QELQE, ALUMIN DHE SHIRITA TË KALLAISURA** (shishe, vazo, kuti teneqeje dhe fletë alumini, enë për ushqime – kuti sardele, etj. – bombola të vogla metalike, tenxhere, lugë, pironj e thika, sende të vogla metalike): tërhiqen një herë në javë; duhet të përdoren kazanë përkatës të kaltër, të cilët jepen nga Komuna. Hedhurinat duhet të jenë të shpëlara dhe pa mbeturina organike; ju lutemi mos i fusni materialet në qese plastike.



**AMBALAZHET PLASTIKE** (shishe, flakonë, shirita, enë dhe vazo plastike, qese, rrjeta ushqimesh, polisterole ambalazhi): tërhiqen një herë në javë; duhet të përdoren thasë të verdhë, të cilat jepen nga Komuna. Hedhurinat duhet të jenë të shpëlara, pa mbeturina organike dhe ku është e mundur të shtypura.



**MATERIALE PREJ LETRE DHE TETRPAK** (ambalazhe prej letre dhe kartoni, fletë dhe copa, revista dhe gazeta, fletëpalosje, cartone për ushqime – qumësht, lëngje, verë, etj.): tërhiqen një herë në javë; materialet duhet të jenë të lidhura ose të futura në qese prej letre ose të futura në kuti prej letre ose kartoni; nuk mund të pranohet përzierja e letrës me materiale të tjera, në veçanti me qese plastike. Hedhurinat në tetrapak duhet të jenë të shpëlara dhe të shtypura.



**PLEHRAT MBETURINA (të thata)**: tërhiqen një herë në javë, duke përdorur më mirë thasë të tejdukshëm; në këto plehëra nuk duhet të futen materiale të diferencueshme.






KONTEJNERAT DHE THASËT DUHET TË NXIRREN JASHTË, NË MËNYRË TË DUKSHME ANËS RRUGËS, PA KRIJUAR PENGESA PËR QARKULLIMIN RRUGOR, BREnda ORËS 06,00 TË DITËS SË TËRHEQJES, NGA PRONARI.

KONTEJNERAT BOSH DUHET TË TËRHIQEN SA MË SHPEJT TË JETË E MUNDUR. PËR SIGURINË E PUNONJËSVE, ÇDO THES OSE KONTEJNËR NUK DUHET TË PESHOJË MË SHUMË SE 15 KG.

ÇDO PRONAR ËSHTË PËRGJEGJËS PËR PASTRIMIN E KONTEJNERIT VETJAK.

Për çdo informacion mund t'i drejtoheni numurit jeshil të Consorzio di Bacino Basso Novarese – 800910902 – nga e hëna deri të premtën: nga ora 08,30 deri 12,30 dhe nga ora 14,30 deri 16,30 (vetëm nga telefonat fikse)

### Calendario raccolte porta a porta Comune di CERANO

		Lun	Mar	Mer	Gio	Ven	Sab
UMIDO			●			●	
VETRO E LATTINE							●
PLASTICA			●				
CARTA E CARTONE		○					
SECCO					●		